



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:198850
Datë: 07.03.2025
Numri i dokumentit: 06952693

C.nr.2044/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.D. nga Komuna e R. – Mali i Zi, të cilin e përfaqëson Faruk Binakaj avokat në Pejë, rruga “Shpëtim Bojku”, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” rruga “T. S.” numër 19 - Prishtinë, baza juridike e kontestit: kompensim i dëmit nga auto – përgjegjësia, vlera e kontestit: 1,000 euro, jashtë seance gjyqësore me datë 07.03.2025, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSTATOHET së është tërhequr padia e datës 15.07.2024, e parashtruar nga paditësi F.D. nga Komuna e R. – Mali i Zi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” rruga “T. S.” numër 19 - Prishtinë, nga baza juridike e kontestit: kompensim i dëmit nga auto – përgjegjësia, vlera e kontestit: 1,000 euro.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij në këtë gjykatë me datë 15.07.2024 ka parashtruar padi kundër të paditurës, nga baza e kontestit: kompensim i dëmit nga auto – përgjegjësia, vlera e kontestit: 1,000 euro.

I autorizuari i paditësit me parashtruesen e datës 04.03.2025 të dorëzuar pranë kësaj gjykate, e ka bërë tërheqjen e padisë, ndaj të paditurës lidhur me këtë çështje juridike kontestimore.

Gjykata në kuptim të nenit 261 par.1,3,4 e lidhur me nenin 387, par 1, pika “c” të Ligjit për procedurën kontestimore vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:198850, 07.03.2025

Udhëzim juridik: *Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa ne kuptim të dispozitës së nenit 261 par. 4 e LPK-së.*

G J Y Q T A R I
Vegim Maloku